

Rezultatet e sondazhit në lidhje me Prioritetet e publikut për buxhetin 2022 - 24

Bashkia Kukës

Rezultati i sondazhit deri në datë **18 Maj 2021 / ora 12:00 pm**



Përgatitur nga Shapo Consulting

Cfarë është ky sondazh?

Sondazhi është ndërtuar mbi bazën e rezultateve të Raportit të Performancës së Bashkisë për vitin 2020. Qëllimi i sondazhit është që të mbledhë mendimin e komunitetit të bashkisë mbi mënyrën sesi bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2020 dhe të kuptojë prioritetet e komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2022-2024.

Së pari dy fjalë në lidhje me Raportin e Performancës 2020. Ky raport është një dokument shoqëruar për raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 të bashkisë tuaj. Ai nuk zëvendëson raportin e zbatimit të buxhetit por synon të flasë përveçse me shifra financiare, të tregojë se cilat kanë qënë objektivat e bashkisë për secilin program buxhetor (lutem nënkupto shërbime që ofron bashkia) dhe çfarë është realizuar nga bashkia për të arritur objektivat e vendosura gjatë vitit 2020. Monitorimi dhe raportimi i performancës së funksioneve që realizon/financon bashkia është një proces i vazhdueshëm nga ana e bashkisë që synon monitorimin dhe raportimin e rezultateve të arritura dhe efijencës së fondeve të përdorura nga ana e bashkisë. Raporti i performancës në ndryshim nga raporti i zbatimit të buxhetit vjetor synon të vijë në një gjuhë të kuptueshme për disa aktorë të rëndësishëm të bashkisë (Këshilli Bashkiak; komunitetin vendor; median etj) dhe përqendrohet në atë që kërkojnë dhe vlerësojnë përfituesit direkt të shërbimeve të bashkisë, pra çfarë ka realizuar konkretisht bashkia me financat e saj. Duke realizuar një plan performance dhe raportimi i realizimit të tij viti pas viti, bashkia synon të masë dhe raportojë sasinë dhe cilësinë e shërbimit vazhdimisht (nga njëri vit në tjetrin). Në këtë mënyrë bashkia duke ardhur me një gjuhë që flet me rezultate (tregues performance) nxit besim midis bashkisë dhe qytetarëve, në këtë mënyrë ajo sjell më shumë transparencë dhe tregon përgjegjshmëri nga ana e saj.

Ky komunikim do të mundësojë më tej pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje nga njëra anë dhe një vendimarrje më të mirëinformuar nga ana e anëtarëve të Këshillit Bashkiak nga ana tjetër.

Pyetjet e sondazhit janë ngritur mbi të dhënat faktike të vitit 2020 në lidhje me peshën e buxhetit që ka harxhuar bashkia për shërbimet / funksionet kryesore që ofrohen si:

- ✓ Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
- ✓ Menaxhimi i bashkisë dhe administratës së saj
- ✓ Shërbimet publike vendore (ku futen gjelbërimi, ndricimi dhe varrezat publike)
- ✓ Arsimi bazë, parashkollori dhe ai i mesëm i përgjithshëm
- ✓ Mbrojtja nga zjarri dhe ajo civile
- ✓ Sport dhe argëtim


Sondazhi gjithashtu pyet komunitetin në lidhje me gadishmërinë e tij për të paguar më shumë tarifa për të përmirësuar apo rritur shërbimet që i ofrohen sot si edhe për të vlerësuar punën e kryetarit aktual të bashkisë.

Rezultatet e sondazhit



Të dhëna të përgjithshme

Kanë plotësuar pyetsorin 1970 persona të komunitetit të bashkisë Has nga të cilët 957 femra dhe 1013 meshkuj në një raport 49% me 51%. Ndër ta 43% e kanë vizituar / lexuar Buxhetin interaktiv të Raportit të Performancës 2020 (elektronik) dhe e vlerësojnë informacionin që ai jep si të dobishëm (dhënë notën 3.80 nga 5 maksimumi).

Pjesëmarrësit në sondazh janë nga:



Përfaqësimi i tyre sipas vendbanimit Njësi Administrative është i plotë duke pasur pjesëmarrës jo vetëm nga qendra e bashkisë (pjesa urbane por edhe nga ajo rurale) por edhe larminë e grupmoshave. Ku nga Kukësi përbëjnë 35% të pjesëmarrësve, dhe grupmosha më dominante është ajo 31-45 vjeç, ndërkohë që 100% e pjesëmarrësve në sondazh janë të gjithë në moshë aktive pune.




Pjesëmarrësit vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë kryesisht të punësuar në sektorin privat dhe atë publik, të papunë, të vetëpunësuar, etj.

Dakordësia për shpërndarjen e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2020

Vihet re një dakordësi e komunitetit në lidhje me mënyrën sesi i alokon paratë bashkia rreth 40% deri në 64% e pjesëmarrësve janë dakord me peshën që i jep bashkia funksioneve / shërbimeve më të financuara nga ana e saj. Pjesëmarrësit kanë sygjeruar se për arsimin bazë përfshirë parashkollorin dhe shërbimet publike vendore paratë duhen shtuar në mënyrë substanciale, ndërkohë që për planifikimin, menaxhimin dhe administrimin duhen ulur fondet e alokuara. Gjithësesi këto përgjigje janë vetëm paraprake pasi vetëm një pjesë e komunitetit e ka plotësuar pyetsorin, i cili është ende i vlefshëm për tu plotësuar edhe në muajt në vijim.


A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë?	Pesha e përgjigjeve të pjesëmarrësve në %			
	Jam dakort	Duhet të shpenzohet me shumë	Duhet të shpenzohet me pak	Nuk e di
54% për Kujdesin social për familjet dhe fëmijet	64%	11%	14%	12%
19% për Menaxhimin dhe administrimin	40%	20%	23%	17%
10% për Shërbime publike vendore	22%	61%	3%	8%
9% për Arsimin bazë përfshirë parashkollorin	34%	50%	3%	14%
3% për Mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen civile	47%	33%	3%	18%

■ Jam dakord ■ Duhet shpenzuar më shumë ■ Duhet shpenzuar më pak ■ Nuk e di



Prioritetet e komunitetit në lidhje me buxhetin 2022 dhe atë 2022-2024

Të pyetur në lidhje me mënyrën sesi sygjerojnë pjesëmarrësit në sondazh për financimin e funksioneve / shërbimeve që ofron bashkia të cilat në buxhetin e vitit 2020 zinin më pak se 3% të tij ata janë përgjigjur se kanë disa prioritete të identifikuar si më poshtë:



Duket qartazi se prioritetet e shumicës së pjesëmarrësve në sondazh janë:


- Rrjeti Rrugor Rural
- Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve
- Papunësia, arsim dhe aftësim
- Shërbimi I pastrimit
- Ujitja dhe Kullimi

E kështu me radhë të listuara sipas peshës së përgjigjeve më poshtë:

Prioritet e komunitetit	Numri i personave	Pesha në %
Rrjeti Rrugor Rural	1003	11%
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	879	10%
Papunësia, arsim dhe aftësim	722	8%
Pastrimi	714	8%
Ujitja dhe Kullimi	643	7%
Shërbimet Bujqësore	630	7%
Furnizimi me ujë	627	7%
Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	558	6%
Planifikimi Urban	545	6%
Ndriçim Rrugësh	523	6%
Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	439	5%
Sport dhe Argëtim	424	5%
Trashëgimia Kulturore	258	3%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	219	2%
Pyjet dhe Kullotat	200	2%
Arsimi Profesional	181	2%
Strehimi	133	2%
Sigurimi shoqëror	64	1%
Policia Vendore	42	0%
Të tjera	1	0%
Total	8805	100%

Gadishmëria për të paguar më shumë taksa e tarifa për më shumë shërbime


Komuniteti është qartazi kundër rritjes së taksave dhe tarifave vendore për më shumë shërbime apo cilësi më të mirë të shërbimeve që ofron bashkia. Rreth 71% e pjesëmarrësve në këtë sondazh nuk janë dakord që të paguajnë me më shumë taksa apo tarifa për këtë qëllim. Pjesëmarrësit janë pyetur në mënyrë të detajuar për disa shërbime që ofron bashkia, qëndrimi i qytetarëve për secilën nga to është shumë i qartë si më poshtë:

A jeni të gatshëm të paguani me shumë taksa dhe tarifa për ofrimin e shërbimeve shtese që keni sygjeruar?	Pesha në %	
Po	29%	
Jo	71%	
Total	100%	

A jeni të gatshëm të paguani me shumë taksa dhe tarifa për ofrimin e shërbimeve shtesë që keni sygjeruar?	Po (në %)	Jo (në %)
Menaxhimi Mbetjeve	28	72
Shërbimet publike (gjelbërim, varrezat, trotuaret etj)	30.5	69.5
Furnizimi me ujë të pijshëm	30	70
Ujitje dhe kullim	28	72
Shërbime të tjera (pyje kullota, zjarrfikëse, parkim, përdorimi hapësirave publike etj)	29.5	70.5
Kopështet dhe çerdhet	27.5	72.5
Total (average)	29	71

Nota e komunitetit për performancën e bashkisë / vlerësimi i kryetarit

Komuniteti i ka dhënë një vlerësim shumë pozitiv të bashkisë. Në total 31% e pjesëmarrësve i kanë vendosur notën 9 dhe 10 bashkisë, 39% i kanë vendosur notën 7 deri në 8 (ose 70% e pjesëmarrësve kanë vendosur notën 7 deri në 10) ndërkohë që 30% e tyre e kanë vlerësuar me notë nga 0 deri në 6 punën e saj.

Notë nga 0 në 10 për vitin 2019 bashkisë?	Numri i votave	Intervali i notave	Pesha në %	
Mbështetës / vlerësues pozitivë	602	9 deri në 10	31%	
Pasivë / Neutralë	771	7 deri në 8	39%	
Kritikues	597	0 deri në 6	30%	
Total	1970		100%	